



Udhëzime në gjuhë të ndryshme në Vantaa

A jeni transferuar së fundi në Finlandë?

A keni nevojë për informacion rreth shërbimeve në Vantaa?

Mirë se vini te udhëzuesi ynë në gjuhë të ndryshme!


Udhëzim dhe këshillim, për shembull për:

- punën dhe studimet
- shërbime shtetërore dhe shbjegimin e vendimeve
- plotësimin e formularëve
- e-services (shërbime dixhitale)
- transferimin në Vantaa
- jetesën në Vantaa
- hobet dhe kohën e lirë

Udhëzimi shumëgjuhësh ofrohet në Myyrmäki dhe Tikkurila, me telefon dhe email.

Shërbimi i dhënies së udhëzimeve ofrohet për të gjithë banorët shumëgjuhësh të Vantaa. Udhëzimi është falas.

vantaa.fi/monikielinenneuvonta



Udhëzime në gjuhë të ndryshme në Tikkurila

adresa: Vernissakatu 1

E HËNË pa takim	E MARTË vetëm me takim	E MËRKURË pa takim	E ENJTE vetëm me takim	E PREMTE pa takim
9.00–15.00	9.00–15.00	9.00–15.00	11.00–15.00	10.00–15.00


Udhëzime në gjuhë të ndryshme në Myyrmäki

adresa: Myyrmäkitalo, Paalutori 3

E HËNË pa takim	E MARTË vetëm me takim	E MËRKURË pa takim	E ENJTE vetëm me takim	E PREMTE pa takim
9.00–15.00	9.00–15.00	9.00–15.00	12.00–17.00	10.00–15.00

Të hënave, të mërkurave dhe të premteve, udhëzimet ofrohen **pa takim** në Myyrmäki dhe Tikkurila. Në këto ditë, ju shërbejmë në gjuhë finlandeze, suedeze dhe angleze të thjeshtë. Disponueshmëria e gjuhëve të tjera të shërbimit nga ekspertët tanë mund të ndryshojë. Nëse është e nevojshme, përdorim përkthim me telefon.

Të martave dhe të enjteve, udhëzimet ofrohet **vetëm me takim**. Me takim, ekspertët tanë janë të disponueshëm në: shqip, arabisht, dari, anglisht, farsisht, italisht, suedisht, somalisht, finlandisht, ukrainisht, rusisht dhe estonisht. Nëse është e nevojshme, përdorim përkthim me telefon.



Ja si të lini një takim:

- Na vizitoni të hënë, të mërkurë ose të premte, ose
- Na telefononi, ose
- Dërgoni një kërkesë me email për të lënë takim. Ju lutemi përfshini numrin tuaj të telefonit në mënyrë që t'ju kontaktojmë.

Na kontaktoni: telefon dhe email

- 09 839 50930 (E hënë–e mërkurë 9–15.30, e enjte 12–15.30, e premte 10–15.30)
- monikielinen.neuvonta@vantaa.fi